



PLANIFIKIMI I BIZNESIT PËR LAJTHINË
- Udhëzues Terreni (fushe)





Shoqata: Federata
e Pyjeve dhe Kullotave
Komunale Qarku Diber

SNV- Organizata Hollandeze për Zhvillim
"Dëshmorët e 4 Shkurtit" Tirana, Albania,
Tel +355 4 2255800, Fax +355 4 2255801.
E-mail balkans@snvworld.org
www.snvbalkans.org

Materialet dhe pikëpamjet e shrehura në këtë studim mundet që të mos reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikën e Organizatave financuese. Mbajtësit origjinal të së drejtës së autorit të informacionit të përdorur janë plotësisht të pranuar. Riprodhimi dhe shpërndarja e materialit në këtë publikim për edukimin ose qëllime të tjera jo komerciale janë të autorizuara me vërtetimin e duhur.

HYRJE

Në fondin pyjor shqiptar, janë mbi 11 mijë hektarë lajthi që takohen kudo nga Shkrelli në veri deri në Skrapar e Kolonjë në jug të Shqipërisë. Pjesa më e madhe e tyre është transferuar në pronësi të komunave. Të vendosura në shpate rreth fshatrave, ata përdoren kryesisht për kullotje. Fermerët kanë filluar të shtojnë interesin për t'i trajtuar këto shkurre të degraduara e për të marrë të ardhura prej tyre. Në zonën fushore bregdetare janë rreth 50 mijë rrënje lajthi të kultivuara në blloqe. Udhëzuesi ka për qëllim të këshillojë fermerët për të bërë projekte për blloqe të reja me lajthi, si dhe për të mbrojtur, rehabilituar e konvertuar për prodhim fruti lajthishtet natyrore. Të dhënat për konsumin, tregun, kërkesat e ofertat janë orientuese.

SHITJET, KONSUMI

Konsumi i lajthisë është i ulët, më pak se 200 ton në vit, tregu kërkon më shumë frutat e qëruara. Fruti përdoret gjërisht në industrinë ushqimore sidomos në atë të ëmbëlsirave dhe likernave. Rreth 15 kompani e përdorin për prodhime të ambalazuara si kek "Buon dolce", apo biskota të tjera me çokollatë. Insika shpk, me bazë në Durrës, përdor mesatarisht 100 kg lajthi të qëruara në muaj në prodhimin e ëmbëlsirave me çokollatë. Sipas rasteve frutat importohen nga Turqia apo burime të tjera.



ARRITJA E TREGUT DHE ÇMIMET

Në tregun e jashtëm lajthitë kanë çmime më të larta se arrorët e tjerë. Aktualisht, tregu jone ka për lajthine çmime më të ulëta se për arrat. Kjo mund të jetë koniukturë e përkohshme e ndikuar nga përqendrimi i prodhimit në një rreth të vetëm dhe mungesa e konkurrencës midis blerësve. Çmimi mesatar për njësi për sasi të vogla të lajthive të importuara është shumë më i lartë (421 lek/kg në 2006).

Çmimet e lajthive në faza të ndryshme të zinxhirit të ushqimit

| Faza në zinxhirin e ushqimit | Lajthitë |
|------------------------------------|--|
| Produkti vendas - çmimi prodhuesit | Vlerësimi: 70- 80 |
| Çmimi i shumicës - në lëvozhgë | Prodhim vendi 100 |
| Çmimi i pakicës - në lëvozhgë | Prodhim vendi 150 Të importuara 90 |
| Çmimi i shumicës të qëruara | Të papjekura 960-1,200 Të pjekura 1,020-1,300 |

Lajthitë e importuara arrijnë deri 30-40 tonë në vit

PRAKTIKA KULTURALE TË TRASHËGUARA TË PËRDORIMIT DHE VJELJES

Historikisht, frutat janë vjelë nga korijet me lajthi natyrore përreth fshatrave për mijëra vjet. Vjelësit kanë qenë barinj të e fëmijët. Shpesh, pjekja e tyre koençidonte me prodhimin e gjethit të dushkut, dhe prania e lajthive sikur lehtësonte procesin. Megjithatë herë pas herë pritej për prodhim thuprash, apo edhe për tu djegur.



Lajthia ka mbijetuar pa asnjë përkujdesim si punimi, plehërimi apo ujitje. Kultivimi i saj u praktikua në të shumtën e rasteve pas viteve '30 të shekullit të kaluar, ku u ngrit dhe i pari masiv me lajthi të kultivuar në Visokë të

Mallakastrës, i cili krahas prodhimit, shërbeu edhe si burim fidanash për dhjetra ferma htetërore të kohës së ekonomisë së centralizuar

PAS VJELJA

Shumica e kultivuesve nëse kanë planifikuar të shesin, përpiqen që ta realizojnë shitjen menjëherë pas vjeljes, për të shmangur telashet e magazinimit. Tharja, kur është e nevojshme, realizohet në mënyrë natyrale **pas larjes**, e shoqëruar më pas me kalibrimin e ndarja në llojë uniform. Me përjashtim të Fierit, Gjirokastrës, Durrësit e Lezhës (së bashku japin 86 % të prodhimit, ku përveç plotësimit të nevojave të familjeve, tepron edhe për të shitur në rrethet e tjera, shitjet janë rastësore dhe prodhimi mbahet për përdorim vetjak ose tregti lokale.

VJELJA

Një pemishte lajthish e mirëmenaxhuar prodhon për hektar afërsisht 2500 kg, ose sa gjysma e asaj të mbjellë me arrë. Lajthitë janë vjelë me dorë dhe përgjithësisht praktikat e vjeljes nuk kanë ndryshuar në vendin tonë këto dy mijë vitet e fundit. Metoda më e thjeshtë është ti lesh të bien në tokë. Fillimi i hapjes zhguallit dhe rënia është shenja që ka filluar pjekja.

Duhet bërë kujdes të shmangët vjelja e parakohshme. Në dy javët e fundit të qëndrimit në pemë pesha e thelbit shtohet në mënyrë të ndjeshme. Fermerët me përvojë si kultivues në kohën e pjekjes kontrollojnë çdo ditë, dhe mbledhin vetëm ato që kanë rënë spontanisht në tokë. Në vitin 2006 u raportua 184 Mt lajthi të prodhuara në gjithë vendin. Kur punohet në një plantacion mjaft të madh, një person mund të mbledhë deri në 50 kg në ditë.



PËRMIRËSIMI I GRUMBUJVE

Si shumë pasuri të tjera të natyrës edhe lajthia është parë si një mall pothuaj pa zot, që e dhuron natyra dhe njerëzit thjeshtë i kanë marrë frutat, thuprat e gjethet. Pyjet e shohin si një vogëlushe xhuxhe të pavlerë, frutikultura e pranon nën hijen e kumbullës, arrës apo qershisë.

VENDNDODHJA E LAJTHI SHTEVE NATYRORE:

E rritur në natyrë, në vendet e zgjedhura prej saj lajthia e 'butë është shkurre. Në vendin tonë gjenden në formë natyrore dy specie lajthish të emërtuar *Coryllis Avellana* L apo e klasifikuar si lajthia e butë; si dhe lajthia e egër (*Coryllis colurna*) e njohur edhe si lajthia turke, që arrin përmasat e një druri me majë piramidale 10 deri 12 metër e lartë dhe në kushte të favorshme deri në 20-30 metër. Takohet fare e rrallë në zona shkëmbore midis zonës së dushkut e të ahut. Në rastin e shartimeve preferohet për nënshartese.

DEMONSTRIME PËR REHABILITIMIN DHE KULTIVIMIN E LAJTHIVE NATYRORE

PROJEKTIMI I VARIANTEVE

Përgjithësisht lajthishtet natyrore kanë numër të madh, mbi 10 mijë lastar për hektar. Dendësia është një ndër shkaqet e prodhimtarisë së ulët si dhe e vështirësive në vjelje. Shërbimi pyjor në bashkëpunim me Federatat rajonale të pyjeve komunale si dhe shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave mund të krijojnë sipërfaqet demonstrative për rehabilitimin dhe kultivimin e lajthishtave ekzistuese

Hapi i parë: përzgjedhja. Preferohen masive që kanë numrin e bimëve të nevojshëm; fshati bie dakord për mbylljen dhe vënien në ruajtje të sipërfaqes demonstrative

Hapi i dytë: përgatitja e projektit të përmirësimit. Bazuar në gjendjen aktuale projekti përcakton radhën e

ndërhyrjeve, rrethim, ricungim apo rrallim, teknologjinë e shartimit, mirëmbajtjen dhe trajtimet pas shartimit, analizën kosto fitime.

Teknologjia e zgjedhur iu bëhet e njohur fermerëve, si dhe ata bien dakord për kujdestarin e sipërfaqes demonstrative. Teknologjia e përgatitur diskutohet e përshtatet me përdoruesit deri sa arrihet vendimi final. Specialisti i ekstensionit duhet të jetë pjesëtar si në përgatitje ashtu edhe vendim marrje e monitorim të demonstrimeve.



AKTIVITETET KRYESORE PËR ZBATIM:

a) Përgatitja e grumbullit të zgjedhur: Tre ndërhyrje konsiderohen si përgatitore, gardhimi sipas kufijve të rënë dakord, prerje rigjeneruese në gjithë sipërfaqen, përzgjedhja dhe lënia e drurëve të së ardhmes, një pjesë e të cilëve do të përdoren si nënshartesa. Këshillohet që të ketë përzjerje të pemëve të shartuara me ato të pashartuara, duke pretenduar për rolin e polenizuesit. Numri i trungjeve dhe forma e lartësi të ndryshme të kurorës mund të përzgjidhen për tu eksperimentuar.

b) Përgatitja e nënshartesave: konsiston në përzgjedhjen e pemëve dhe pozicionit të tyre, shënimi dhe prerja e tyre. Këshillohet që shartuesit të kontraktohen nga fermerët dhe të kenë eksperiencë për realizimin e shartimit.

c) Përzgjedhja e kalemave. Ka pak njohuri për drurët mëmë të disponueshem. Tre mund të konsiderohen mundësitë kryesore:

1. pemëtoret ekzistuese;
2. koleksioni me disa kultivarë Spanjoll në fidanishten e fshatit Qenam (Rajmonda Nako 2009).
3. importimi dhe testimi i kultivarëve amerikan Barcelona Ennis, Leis dhe Casina, apo të tjerë të rekomanduar.

Si për fidanët e shartuar, ashtu edhe ato që mund të vendoset të lihen në rolin e pjalmuesit, do të përzgjidhet mënyra e trajtimit, me një kërcell të vetëm, 2 ose tre kërcelj anësore krahas atij kryesor apo më shumë kërcelj. Lartësia e kurorës mund të fillojë nga 60 cm deri në një metër.

Një kultivues nga Dibra është përdorues i rreth tre dynim me lajthi natyrore. Ai tregon se di të trajtojë mollën e kumbullën por nuk ka trajtuar asnjëherë lajthitë. Unë kam një lajthishtë të degraduar, në planin e mbarështimit është parashikuar të lihet në gjendjen ekzistuese, unë në fakt dua ta krasis e ta përmirësoj, kur është koha më e mirë për ta krasitur dhe sa rëndë mund ta krasis atë?

Përpara krasitjes është mirë të bësh një vëzhgim të hollësishëm se sa është dendësia e bimëve, si dhe cila është gjendja e tyre.

Krahas kësaj do të këshillohesh me specialistin e ekstensionit në komunë. Do ti shpjegosh se çfarë ke në mendje dhe çfarë kërkon të arrish dhe ai do të rekomandojë trajtimet përfshirë edhe krasitjen. Nuk e di as se si do që të duket në të ardhmen lajthishta jote. Lajthia mund të pritët rrafsh me tokën. Në pranverën e ardhshme ajo do shpërthejë dhe do të jetë plot me lastarë të rinj. Kjo njihet si ricungim, një trajtim tradicional nga fermerët që e përdorin lajthinë për të prodhuar thupra për gardhe, kosha apo shporta. Ajo mund të rrallohet dhe filizat e mbetur pas rrallimit mund të krasiten për tu dukur si pemë, me një trung kryesor, por do që ta mbash nën vëzhgim e të heqësh vazhdimisht lastarët që çelin veçanërisht vitet e para. Në fakt, duket shumë bukur nëse do të vendosësh ti japësh këtë formë. Mund të fillojë të prodhojë edhe lule e fruta. Trungu ka formë të bukur me gunga, kurora plot me degëza e gjethe, me ngjyra që ndryshojnë sipas stinëve, me dy lloje lulesh gjatë dimrit. Nëse vërtet vendosh ta krasisësh, është mirë që këtë ta bësh në Janar - Shkurt.

KUR FLENË LAJTHITË NATYRORE

Lajthia është vetë sterile; polen i prodhuar nga lëvaret e një varietetit si rregull nuk pllenon lulet femërore të të njëjtit varietet.

Lulet mashkullore dalin në dimër, disa herë në tufëza, dhe gradualisht zgjaten e lëshojnë polenin. Lulet femërore janë të grupuara në degëza të zhveshura janë të vogla me ngjyrë të kuqe me dy kreza të përkulura në majë. Kokrra e polenit, e ardhur nga varietetet me përputhje, mbin në bazën e lules femërore brenda 4-7 ditëve pas pjalmimit, por më pas zhvillimi ndërpritet dhe mbetet në gjendje qetësie për 5-6 muaj. Herët në verë, vezorja zmadhohet dhe një zhguall i gjelbër formohet rreth tij. Kur lëvozhga arrin gjysmën e madhësisë, ovula zhvillohet brenda dhe ndodh pllenimi.

Nëse është i suksesshëm nis të formohet lajthia e gjelbër që në fund të verës shndërrohet në të kafenjtë, gjethet bëhen të kafenjtë në të argjend dhe kokrrat fillojnë të bien. Megjithëse gjethet bien në dimër, nuk mund të thuhet se bima fle, pasi ajo është në proces gradual lulëzimi

METODAT E SHTIMIT

Vendimi i fermerit për të mbjellë apo shartuar lajthi duhet të shoqërohet me zgjedhjen e pjalmuesit, që duhet të jetë i pranishëm në fidanishte apo pemëtore, pasi mundet që për ndonjë kultivar, pjekja e luleve femërore të mos koincidojë me ato mashkullore.



Kjo do të sigurojë polenizimin e kryqëzuar. Është e këshillueshme të jenë rreth 20% e numrit të pemëve në rolin e polenizuesit dhe ata këshillohen që të kenë largësi maksimale jo më shumë se 15- 20 metër nga pema që duam të pjalmojmë.

METODAT E SHUMEZIMIT:

Shumëzimi me copa

Përdorimi i copave me gjethë me ngrohje në pjesën fundore gjatë rrënjëzimit si dhe të trajtuara me acid indol bytiric (AIB) apo me hormone ka pasur rezultate modeste. Lagështia e lartë me mjegull të ventiluar e përdorur nga disa prodhues ka rezultuar në rritje të rezultateve të rrënjëzimit, por shpesh fidani bëhet i ndjeshëm apo shoqërohet me nekroza.

Shtimi me farë

Fidani i Lajthisë që vjen nga mbirja e farës jep fruta të ndryshëm nga bima që i ka prodhuar. Përgjithësisht nuk aplikohet, pasi është me ekonomik prodhimi i fidanëve me mbathje.

SHARTIMI

Lajthia natyrore e vendit, rekomandohet si nënshartesë e mirë pasi lëngëzon pak. Rrënja boshtore e thellë ndikon në rritje të rezistencës karshi thatësisirës. Por duhet mbajtur parasysh se farërat e këtyre llojeve mbijnë me vështirësi, ashtu siç rrënja boshtore e gjatë, e vështirëson transplantimin e tyre. Lastarët e shkurreve natyrore duken më të përshtatshmet për këtë. Faktori i përbashkët në të gjitha metodat e



përdorura për shartim është "Kambiumi", një unazë e ngushtë me qeliza, që realizon lidhjen e bimës me kalemin, duke bërë që tubat të përçojnë ujin dhe lëndët minerale nga bima tek kalemi e anasjelltas.

Shartimi me gjuhëz e lidhje

Shartimi me gjuhëz mund të realizohet në mes të dimrit. Duhet treguar kujdes që nënshartesa dhe kalemi të jenë në gjumë përpara shartimit. Nëse ka filluar lëngëzimi, dhe lëvizja e lëngut nga poshtë lart në nënshartesë, ura lidhëse e kallusit midis nënshartesës e kalemit nuk formohet

Shartimi është operacion që duhet të realizojë lidhjen e indeve, që uji dhe lëndët ushqyese të shkojnë nga rrënjët e nënshartesës tek sythet e kalemit të vendosur. Prerja e nënshartesës dhe mbishartesës duhet bërë e lëmuar me thikë të mprehtë. Është mirë që lidhja të bëhet me rafie, apo lidhëse të tjera që përdoren për shartim, por nuk duhet shtrënguar shumë.

Fidanët e shartuar vendosen në serë me ngrohje për disa javë deri sa të realizohet bashkimi i pjesëve të shartimit. Pjesa e shartuar duhet të ruhet nga dielli, që indi i kambiumit të formohet shpejt. Shartesat e zëna fillojnë të aklimatizohen hap pas hapi deri sa vendosen në mjedisin natyror.

FIDANAT NGA KËMBËZAT

Metoda kryesore e shtimit, është mbathja e bazës së lajthisë me dhe në forme shtrati, për të prodhuar fidana me rrënjë. Si në figurë, baza nga dalin kërcenjët mbulohet me dhë të përzier me humus e rërë. Kjo kodërzë e krijuar në bazën ku kanë dalë lastarët, këshillohet të mbahet e lagur dhe bima mëmë plehërohet e ujitet për të siguruar rritje optimale. Kur kushtet janë të favorshme, sythet e mbuluar të bazës shpërthejnë, duke nxjerrë lastarë që kalojnë mbi kodrinën deri një metër lartësi si dhe rrënjë që depërtojnë në kodrinëzë. Gjatë periudhës së gjumit dimëror,

kodërza me dherishte largohet me kujdes dhe çdo llastar i ri me sistemin e tij rrënjor pritët si këmbëz, duke e ndarë nga bima mëmë. Pemët e reja janë gati për mbjellje

Shumëzimi in vitro

Duhet mbajtur parasysh se mikroshumëzimi shkurton kohën e përgatitjes së nënshartesës që me mbathje do kohë të gjatë. Kjo metode realizohet në kushte laboratorike duke përdorur teknika in vitro.

Aplikohet për të siguruar nënshartesa, apo edhe fidana, kur kërkohet numër i madh për mbjellje. Pjesë të indeve të bimës, zakonisht rritjet në afërsi të skajit apo majës, merren nga bimët prindër që janë rritur në kushte të kontrolluara. Këto copëza quhen *eksplante*. Këto sterilizohen përpara se të vendosen në mjedisin ushqyes. Bilanci i ushqyesve me hormonet bimore në këtë mjedis përcakton tipin e rritjes së eksplantit. Gjatë stadit të parë, mjedisi mbështet daljen e një bisku dhe më pas ai transformohet në një mjedis shumëzimi, ku numri i bisqeve rritet shumë shpejt. Eksplantet më pas ndahen, dhe trajtohen me stimulues rrënjëzimi, duke u mbjellë përsëri në mjedis shumëzimi.

Bimëzat fillojnë gradualisht të forcohen në mjedis sere dhe më vonë në kushte natyrore.



NGRITJA E BLOQEVE ME LAJTHI TË KULTIVUAR

Zgjedhja e tokës

Ndërsa si bimë natyrore rritet në toka me veti të ndryshme, kur kultivohet për treg, preferohen toka lymore ranore me pehazh 6-7. Rrënja boshtore është e thellë, ata anësore janë relativisht të cekëta. Pemët që mbillen në toka të thella, zhvillohen shpejt e mirë dhe japin më tepër prodhim.

Tokat duhet të jenë të kulluara e të pasura me lëndë organike. Tokat e lehta ranore apo lymore kërkojnë pleh organik, tokat e rënda e kompakte duhen bërë thellë qilizme para mbjelljes së pemëve.

Terreni

Tokat e pjerrëta duhen shmangur pasi nuk futet mekanika e rritet kostoja e shërbimeve apo vjeljes, për të siguruar prodhime të pastra biologjike preferohet që kopshti i lajthive të jetë i izoluar nga zonat e ndotura industriale. Kunddrejtimi ndikon si në ndriçimin diellor ashtu edhe në intensitetin e ngricave, ndërsa fundet e luginave të pa ajrosura janë të rrezikshme për ngricat e pranverës, kur lajthia ka filluar të lidhë kokërr.

Nga ana tjetër duhet studiuar bimësia e mëparshme. Mbeturinat e sistemit rrënjor mund të bëhen shkak për infeksion nga Armillaria, një kërpudhë që shkatërron sistemin rrënjor të pemëve.

Kufitarët dhe kafshët pa bari

Nëse fermerët kufitarë e përdorin tokën e tyre për kullotë, veçanërisht kur mbajnë blegtori të imët, lepuj apo pula, duhet menduar mirë përpara se të vendoset për mbjelljen e lajthive. Në rastin kur nuk arrihet marrëveshje për heqjen e blegtorisë së imët apo lepujve e shpendëve, është mirë që të hiqet dorë nga mbjellja. Edhe në rast se arrihet marrëveshje, gardhi për rreth pemishtes është i domosdoshëm. Përgjithësisht, në dimër shumë fermerë i lënë sall të imtat, po ashtu u lidhin dy këmbët dhe lëshojnë kafshët e samarit. Lastarët e lajthisë në këtë periudhë janë të mbushur me lule dhe preferohen nga kafshët.

Kjo duhet të merret në konsideratë përpara mbjelljes.

Organizimi i bllokut të lajthive

Hapësira midis pemëve si dhe drejtimi i rreshtave duhet të vendoset pasi të jetë studiuar drejtimi i erërave, drejtimi predominues i rrezatimit diellor, kullimi dhe metoda që do

të përdoret për vjelje. Disa kultivues rekomandojnë që në një bllok me lajthi të mbillen rreth 20% e pemëve në rolin e pjalmuesit.

Përgjithësisht, kur është e mundur rreshtat orientohen veri - jug për të përdorur në maksimum ndriçimin diellor. Distanca nga pema në pemë është një vendim individual i fermerit, bazuar në kushtet tokësore, klimën e menaxhimin. Pemët e mbjella në katror me brinjë 4.5m i korrespondon 493 drurë për hektar, kurse mbjelle me distanca 6 m me 6 m në një hektar vihen 277 lajthi. Shumë kultivues mbjellin në distancë 5.5 m me 5.5, pasi duket e përshtatshme për makineritë, si dhe mundëson rritjen e kurorave.

Por përderisa pemët janë të reja, duket që mbetet hapësirë e madhe e pambuluar në kopsht. Nëse i dyfishojmë pemët, fillimisht duket si me kosto të lartë, por nga shumë fermerë preferohet, pasi shfrytëzon më mirë hapësirën në gjithë jetën e pemishtes.


Në këtë rast pemët e dubluara hiqen nga pemëtorja pas 10-12 vjetësh. Rreshtat mbahen 5.5-6 metër larg njëri - tjetrit.

Teknikat e mbjelljes

Përpara mbjelljes duhet të bëhet pastrimi i ngastrës nga barërat ekzistuese. Përgjithësisht nuk rekomandohen plehërime në pemët e sapombjella.

Disa nga fermerët bëjnë plehërim të gjithë ngastrës me superfosfat përpara mbjelljes. Kur është e mundur është mirë të instalohet paraprakisht sistemi ujitës. Si shihedhësit ashtu edhe sistemi i ujitjes me pika janë të përshtatshëm.

Mbjellja realizohet në dimër. Përgjithësisht fidanët janë pa bukë dheu, prandaj duhet bërë kujdes për shtratifikim e banjëzim. Pas piketimit, bëhet hapja e gropave. Diametri i gropave rekomandohet mbi 30 cm që të mbajë sa më mirë sistemin rrënjor. Fundi i gropës mbushet me dhë të zgjedhur



në formën e një kodrine deri në dy të tretat e saj dhe rrënjët shpërndahen me kujdes përreth kodrës përpara se të mbulohen me dheun e zgjedhur. Për shkak të rëndësisë që ka polenizuesi është mirë që çdo rresht ti vëmë një etikete me emrin e kultivarit të mbjellë. Kjo zgjidh problemin edhe nëse do të kemi nevojë për ndonjë zëvendësim pas vitit të parë duke shmangur gabimet.

Për të inkurajuar lajthi me një trung të vetëm se sa shkurre me disa trungje, maja e fidanit të mbjellë pritet në momentin e mbjelljes. Rreth pesë sythe i lihen në të fidanit dhe pjesa tjetër e sythave që gjenden më poshtë hiqen me kujdes me gishta. Për të mbrojtur trungun nga djegia e diellit ajo mund të lyhet me bojë të bardhë plastike që hollohet në raportin 1:1 me ujë, apo vishet me kashtë thekni, e lidhet me kujdes për tu mbrojtur nga lepujt.

Mulciritimi me gjethe apo kashtë është mjaft i dobishëm për të ruajtur lagështirën.

Trajtimi i pemëve të reja

Shumica e kultivuesve i kontrollojnë bimët e këqija duke bërë mulcirim për rreth pemëve të reja, si dhe duke prere degëzat që tentojnë të dalin në bazën e pemës, apo duke prashitur për të hequr barërat në afërsi të pemës.

Për të realizuar rritje optimale është mirë që toka të mbahet e lagët gjatë gjithë sezonit të rritjes intensive. Megjithëse mulciritimi ndihmon

në ruajtjen e lagështirës, nëse duam rritje intensive është e rëndësishme ujitja. Menjëherë pas çeljes së sythave në pranverë është i nevojshëm plehërimi me nitrate.

Ka tre metoda për ti dhënë formë pemës: pemë me një trung të vetëm; me 2-4 kërcej; si dhe me shumë kërcej.



Më i dëshirueshmi në rastin e pemëtoreve me destinacion tregtar janë pemët me një kërcell të vetëm. Për të këtë qëllim duhet të hiqen vazhdimisht lastarët që shpërthejnë. Për të formuar pemë me disa kërcëj, krahas kërcellit kryesor përzgjidhen edhe dy-tre anësor të shëndetshëm që trajtohen për ti kthyer në trungje përreth atij kryesor. Prezenca e disa trungjeve e bën pemën më rezistente për vendet me erë, por ata duhen pastruar nga degët e poshtme për të mundësuar zhvillimin e një kurore të rregullt dhe kualitet të lartë frutash. Në prodhim futen rreth moshës 6 vjeçare, dhe një bllok i menaxhuar mirë mund të mbetet aktiv e të japë prodhim të bollshëm për 40 vjet apo më tepër.

Tabele: Analiza kosto fitime për ngritjen e bllokut, shërbimet dhe të ardhurat

| Aktivitetet | Shpenzime /lek | Fitime | Balance | |
|---|----------------|--------|---------|--------|
| Fidanët (500 për hektare) | 25000 | 0 | -25000 | |
| Përgatitja dhe mbjellja | 15000 | 0 | -15000 | |
| Shërbime kulturore për pemët e reja për 5 vjet | 50000 | 0 | -50000 | |
| Shpenzime për pemët në prodhim nga viti i pestë në të dhjetin | 50000 | 100000 | 50000 | |
| Shpenzime për pemët në prodhim nga viti i pestë në të dhjetin | 60000 | 200000 | 140000 | 100000 |

EKSPERIMENTO SOT TË KURSESH NESËR

Çelësi i suksesit kur duam të fillojmë një biznes të ri është siguria shkencore dhe kur është fjala për një projekt kopshtarie siç është rasti i kultivimit të lajthisë natyrore, kërkimi shkencor është i natyrës ekstensive. Në vendin tonë nuk ka eksperiencë për të rehabilituar dhe kultivuar masivet natyrore të lajthisë. Kjo bën të domosdoshme ngritjen e eksperimenteve demonstrative sa më të lehta për tu monitoruar nëpërmjet matjeve të vazhdueshme. Është e rëndësishme që eksperimentimi të bazohet mbi disa parime,

sipas të cilave zbatimi kërkon një minimum pune shtesë. Këto parime janë:

- Të gjithë demonstrimet krahasuese duhen bërë me referim me dëshmuetin
- Duhet shmangur variacionet e tepruara të faktorëve, që të mbahet një krahasues i thjeshtë për t'u interpretuar
- Për një variant që jemi të bindur, duhen bërë sa më shumë përsëritje me të njëjtat trajtime, për të mundësuar vërtetësinë.
- Çdo demonstrim duhet të ketë së paku njëqind pemë, që i nënshtrohen të njëjtit trajtim, që rezultatet të jenë të interpretueshme
- Zona e demonstrimit duhet të ketë përreth një zonë ndihmëse me të njëjtat pemë e të njëjtin trajtim, që të shmanget ndikimi i efektit anësor

Si t'i aplikojmë këto rregulla për kultivimin e lajthisë natyrore

Para së gjithash, duhet rënë dakord që përpara se të fillojmë eksperimentimin e shartimit të lajthisë natyrore është me shumë rëndësi njohja në detaje e teknologjisë së shartimit e provuar në kushte e afate të ndryshme. Së dyti duhet të kemi siguruar burime të provuara për prodhimin e kalemave.

Kjo kërkon disa aktivitete përgatitore:

- Përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për zgjidhjen e sipërfaqes demonstrative
- Zgjedhja e sipërfaqes demonstrative
- Identifikimin e pranisë së lajthive të buta të përshtatshme për prodhimin e kalemave si dhe pranueshmërinë e pronarëve të tyre për të përdorur lajthitë nëna për të prodhuar kalema.
- Realizimin e marrëveshjeve midis rritësve të lajthive të kultivuara dhe kandidatëve për të ngritur sipërfaqe demonstrative për shartim.
- Mbyllje me anë të gardhimit të sipërfaqes së caktuar demonstrative, realizimi i ndërhyrjeve sivikulturore si cungimi, rrallimi.
- Përzgjedhja e lastarëve të përshtatshëm për metodat e shartimit të zgjedhura për tu eksperimentuar.
- Punëtor me eksperiencë fillojnë shartimin duke aplikuar metoda të ndryshme sipas projektit të miratuar.

Projektet e përgatitura për demonstrim së bashku me përllogaritjet financiare u përcillen donatorëve të ndryshëm që nga Ministria, MADA etj., për mbështetje financiare sidomos për rrethimin e sipërfaqeve që kandidojnë për demonstrime si dhe fillimin e trajtimit të nënshartesave të ardhshme

Ekspërimento duke zbatuar parimet e rekomanduara:


- 1. Nevoja për dëshmues.** Në çdo sipërfaqe demonstrative duhet llogaritur që sipërfaqja të jetë së paku sa dyfishi i asaj të zgjedhur, për të krahasuar ecurinë e bimëve dhe të prodhimit me ndërhyrje dhe pa ndërhyrje
- 2. Nevoja për të respektuar të njëjtin trajtim:** Kjo presupozon që i gjithë demonstrimi do të realizohet duke bërë të njëjtën ndërhyrje, si p.sh, të njëjtin rrallim, të njëjtin numër kërcejsh për cung, nëse do të bëhet plehërim të njëjtën normë plehërimi, të njëjtën metodë shartimi, pra trajtim i njëjtë në të gjithë sipërfaqen demonstruese.
- 3. (Parimi i tretë dhe i katërt) mundësia e përsëritjes** të paktën dy herë të të njëjtit variant si dhe me një numër minimal bimësh mbi njëqind për secilin, mund të ketë një farë fleksibiliteti në rastin e eksperimentimit të metodave të shartimit, duke ruajtur kultivarin e mbishartesë, por duke krijuar variante të ndryshme në metodat dhe afatet e shartimeve.
- 4. Domosdoshmëria e një zone izolimi** ka të bëjë me efektet, për shembull të ndriçimit në pjesët e jashtme të grumbullit, me sulmin nga kafshët e të tjera ndikime që bëhen shkak për të devijuar rezultatin.

Në figurën më poshtë jepen skemat e rekomandueshme për vendosjen e sipërfaqeve prove demonstrative, si dhe skemat e rrallimit apo të trajtimit të kurorës apo shartimit

Trajtimet silvikulturore:

- Studimi i efektit të ricungimit, dëshmuesi pa ricungim, sipërfaqja minimale 1000 m²
- Studimi i varianteve të ndryshme të rrallimit, skema e bimëve të mbetura, 1*1 m; 2*2m; 3*3m; 4* 4m; sipërfaqja minimale për çdo variant 1000 m²; të gjithë variantet do të trajtohen me të njëjtën mënyrë të trajtimit të kurorës, në vartësi të vendimit që merret për një, dy apo shumë kërcej për çdo pemë

- Studimi i varianteve për formën e kurorës dhe numrin e kërcejve: në këtë rast eksperimenti do të fillojë me ricungimin dhe secili nga variantet do të ketë të njëjtin numër bimësh për njësi të sipërfaqes.
- Të gjitha këto eksperimente është e rëndësishme që të mundësohet ndjekja e tyre për një periudhë minimale 10 vjeçare.



Eksperimentimi i shartimit

Metodat që do të krahasohen:

- a. Shartimet me syth të fjetur: studiohet afati dhe mënyra. Afati midis 15 korrik - 20 gusht; tre mënyrat e shartimit me syth të fjetur janë: shartimi me unazë, shartimi me drejtkëndësh dhe shartimi në formë T.
- b. Shartimi pranveror me kalema; kalemata përgatiten që në janar, ambalazhohen sipas standardeve, nënshartesa do të përgatitet në fund të prillit e fillim të majit. Eksperimentohen dy mënyra shartimi në vartësi të dimensioneve të nënshartese; shartim me çarje si dhe shartim nën lëkurë. Rekomandohet të eksperimentohet prerja e nënshartesës në dy nivele; prerja 5 ditë para shartimit, për të evituar lëngëzimin dhe prerja 5 cm poshtë saj në kohën e shartimit, për të eksperimentuar shmangien e efektit të lëngëzimit



SNV zhvillim i kapaciteteve për impakt

Puna kryesore e SNV është të forcojë kapacitetet e organizatave lokale, të mbështesë aktorët lokalë që të rrisin kapacitetet për të zgjidhur problemet e tyre, ndjekur objektivat e tyre të zhvillimit dhe kontribuojnë në reduktimin e varfërisë. SNV punon me aktorë privatë, publikë dhe të shoqërisë civile që të ndihmojë në ndërtimin e urave midis tyre, që të rrisin impaktin dhe përmirësojnë qeverisjen.

SNV bashkëfinanconi me Sida me projektin "Forcimi i qëndrueshmërisë së pyjeve komunale", i cili synon forcimin e praktikave menaxhuese të decentralizuara të pyjeve dhe kullotave, si një mjet për zhvillimin të qëndrueshëm ekonomik në nivel lokal.

SNV - Organizata Hollandeze për zhvillim
"Dëshmorët e 4 Shkurtit" Tirana, Albania,
Tel +355 4 2255800, Fax +355 4 2255801.
E-mail balkans@snvworld.org
www.snvbalkans.org